# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5686
E shtunë, 26 janar 2019
çmimi 0.40 €


## Ambasada e ShBA-së kërkon pezullimin e taksës

FAQE 7




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


FLET PËR "EPOKËN E RE", GJENERALLEJTËNANT RRAHMAN RAMAI FAQE 4-5

# Ushtria po e thellon bashkëpunimin me ShBA-në



Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, ka bërë me dije se pas fillimit të tranzicionit të FSK-së, ushtria vetëm po i thellon raportet me ShBA-në. Ai nuk beson që raportet e Qeverisë me ShBA-në për shkak të taksës për mallrat serbe do të mund të ndikojnë në bashkëpunimin e FSK-së me partnerët e saj strategjikë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se të gjitha përgjegjësitë dhe kapacitetet aktuale të FSK-së që dikur kanë qenë nën përgjegjësinë e KFOR-it, gradualisht po barten te FSK-ja. Gjenerallejtënant Rama ka bërë me dije se viti i parë i tranzicionit të FSK-së ka të bëjë më tepër me çështje administrative në ministri dhe për ndërtimin e Shtabit të Përgjithshëm, por edhe për ndërtimin e kapaciteteve trajnuese për misionin dhe mandatin e ri

# Lirohet Sylejman Selimi



Ish-komandanti i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Sylejman Selimi, është liruar të premten me kusht nga burgu. Lirimi i tij është bërë pas qëndrimit në burg për më shumë se pesë vjet. Lirimi i gjeneral Sylejman Selimit është mirëpritur nga familjarët, miqtë, bashkëluftëtarët dhe drejtuesit e institucioneve shtetërore e të partive politike FAQE 3



## Vetëm 208 persona kanë aplikuar për legalizim të armëve

FAQE 2

## AKTUALE

### 2019-ta, VIT I EKONOMISË DHE PUNËSIMIT F. 11



Gazmend ABRASHI

### SBASHK-U NUK TËRHIQET NGA GREVA F. 7

### HOTI: KQZ-ja PO BLLOKOHET ME QËLLIM F. 6

## EKONOMI



### QEVERIA DHE KOMISIONI PËR ZHVILLIM MIRATUAN DRAFTIN E RI TË STATUTIT TË 'TREPÇËS' F. 8

### VESELI TAKOI PËRFAQËSUESIT E ODAVE EKONOMIKE, U PREMTON MBËSHTETJE F. 8

## KULTURË

### HAPEN ZYRTARISHT ZYRAT E MKRS-së NË QYTETIN E PRIZRENIT F. 17



## SPORT

### PAPUQI: MOSZHVILLIMI I ASNJË NDESHJE ZYRTARE PËR KOSOVËN, PENGU MË I MADH NË KARRIERË F. 18


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@mt.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## VMRO-DPMNE kthen sytë kah shqiptarët



SHKUP, 25 JANAR - Partia opozitare maqedonase VMRO-DPMNE i kthen sytë kah shqiptarët. Anëtari i saj, Vllatko Gjorçev, shpalli kandidaturën për president dhe shprehet i gatshëm t'ua zgjasë dorën shqiptarëve për t'i kërkuar votat e tyre. Gjorçev, i cili në opinionin shqiptar njihet si një ndër eksponentët e protestave kundër Fakultetit të Pedagogjisë në gjuhën shqipe, tani konsideron se Maqedonia është shtet i të gjithëve dhe se të gjithë së bashku duhen angazhuar për ta përmirësuar.
Gjorçev thotë se shqiptarët janë të zhgënjyer nga qeveria dhe premtimet e saj e këtë gjë, sipas tij, e vërteton eksodi në rajonet me shumicë shqiptare. "Dera nga ana ime është e hapur dhe dora e zgjatur", ka thënë ai. Sipas Gjorçevit, qytetarët e Maqedonisë i ka bashkuar gjendja e keqe ekonomike dhe për këtë arsye kërkojnë ndryshim. Ligjvënësi opozitar është i vetmi emër në garën e VMRO-DPMNE-së për kandidatin presidencial. Ai pretendon se jo vetëm ka aftësitë e duhura për të marrë në dorë postin e kreut të shtetit, por thotë se gëzon mbështetjen e qartë të shumicës së deputetëve opozitarë dhe anëtarëve të partisë.

# Vetëm 208 persona kanë aplikuar për legalizim të armëve

Në diskutimin e organizuar të premten për planet konkrete lidhur me fushatën e legalizimit të armëve ilegale, zyrtarë të MPB-së kanë bërë me dije se deri më 23 janar për legalizim të armëve në tërë Kosovën kanë aplikuar vetëm 208 persona



EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 25 JANAR - Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), në kuadër të fushatës së legalizimit të armëve ilegale "Me letra" dhe në bashkëpunim me projektin për siguri në Kosovë, të Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP), ka organizuar të premten diskutim për progresin e deritanishëm dhe planet konkrete të ardhshme lidhur me këtë fushatë. Nga zyrtarë të MPB-së është bërë me dije se deri më 23 janar për legalizim të armëve kanë aplikuar në tërë Kosovën vetëm 208 persona.
Zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Izmi Zeka, ka thënë se Ministria e Punëve të Brendshme është e përkushtuar që të kontribuojë dhe t'i zbatojë plotësisht aktivitetet e procesit të legalizimit në përputhje me Udhërrëfyesin për një zgjidhje të qëndrueshme për posedimin, keqpërdorimin dhe trafikimin e paligjshëm të armëve të vogla dhe të lehta dhe municionin e tyre në rajonin e Ballkanit Perëndimor deri në vitin 2024. "Kjo fushatë do të zgjasë për gjashtë muaj dhe mbështetet në zbatimin e Ligjit për legalizimin e armëve. Qëllimi i saj është të ofrojë informata se çfarë duhet të dijë çdo qytetar për legalizim dhe t'i inkurajojë ata që të ndërmarrin këtë veprim", ka deklaruar zëvendësministri Zeka.
Alessandra Roccasalvo, përfaqësuese e përhershme e UNDP-së, ka thënë se kjo organizatë është duke e mbështetur këtë kampanjë financiarisht me disa partnerë. "UNDP-ja është e përkushtuar për ta promovuar konceptin e sigurisë njerëzore. Kosova është e vogël dhe ka një përparësi që ta përmbushë këtë standard", tha ajo. Ndërsa ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Christian Heldt, ka përgëzuar Qeverinë e Kosovës për punën e bërë në këtë drejtim, me ç'rast ka rikonfirmuar mbështetjen e mëtejme të shtetit gjerman për luftimin e posedimit të armëve ilegale.
Fushata e legalizimit është pjesë e përkrahjes afatgjatë nga projekti për sigurinë në Kosovë (KSSP) i UNDP-së dhe u mundësua përmes kontributit të Ministrisë së Punëve të Jashtme gjermane. Fushata e legalizimit "Me letra" ka filluar më 17 dhjetor 2018 dhe do të zgjasë deri më 17 qershor 2019.

**KËTO JANË KOMUNAT KU QYTETARËT KANË APLIKUAR PËR LEGALIZIM TË ARMËVE:**

Prishtinë - 51 aplikantë
Gjilan - 40 aplikantë
Ferizaj - 12 aplikantë
Prizren - 22 aplikantë
Gjakovë - 40 aplikantë
Pejë - 36 aplikantë
Mitrovicë e Jugut - 7 aplikantë
Mitrovicë e Veriut - ende asnjë aplikim

## Protesta e 16 shkurtit, zbardhet plani i organizimit



TIRANË, 25 JANAR - Mediet në Shqipëri kanë zbardhur planin e opozitës për nisjen e përgatitjeve të protestës kombëtare të 16 shkurtit, e cila parashikon të japë një sinjal të fortë kundër Qeverisë së kryeministrit Rama, ku qëllimi final është rrëzimi i tij nga pushteti. Për të arritur këtë objektiv, sipas një plani paraprak, Partia Demokratike do të zhvillojë takime intensive para datës së protestës për t'i bindur qytetarët që të jenë të shtunën e 16 shkurtit në orën 11:00 përpara Kryeministrisë. Sipas një udhëzimi të dalë nga zyra e Bashës, kërkohet që mes datave 2 dhe 12 shkurt të organizohen protesta lokale në rrethe.
Në vendimin e marrë në Kryesinë e PD-së është parashikuar që të ketë takime derë me derë me qytetarët për t'i ftuar ata në protestën e 16 shkurtit dhe protestat lokale. Organizatorët dhe koordinatorët nëpër rrethe duhet të marrin masa sipas udhëzimit për evidentimin dhe pjesëmarrjen e simpatizantëve me qëllim të vlerësimit të kontributeve.
Të gjithë deputetët dhe zyrtarët e PD-së janë urdhëruar që të përcjellin te qytetarët mesazhin e protestës dhe sigurimin e pjesëmarrjes së tyre maksimale me të gjitha format. Përveç takimeve derë më derë me qytetarët, në banesa dhe ambiente publike do të ketë edhe fletëpalosje, njoftime në rrjetet sociale, telefonata dhe sms. Ashtu siç ndodh rëndom në protesta të tilla masive, PD-ja është kujdesur edhe për logjistikën e transportit, caktimin e vendit të nisjes nga dega, grumbullimin në kohë të të gjithë simpatizantëve dhe masat lehtësuese për ushqime dhe ujë gjatë rrugës. Ndërkohë PD-ja ka përzgjedhur edhe koordinatorët dhe zyrtarët që do ta organizojnë protestën në rrethe.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Është liruar me kusht nga burgu ish-komandanti i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, Sylejman Selimi

# Lirohet Sylejman Selimi

Ish-komandanti i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Sylejman Selimi, është liruar të premten me kusht nga burgu. Lirimi i tij është bërë pas qëndrimit në burg për më shumë se pesë vjet. Lirimi i gjeneral Sylejman Selimit është mirëpritur nga familjarët, miqtë, bashkëluftëtarët dhe drejtuesit e institucioneve shtetërore dhe të partive politike



EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 25 JANAR - Ish-komandanti i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Sylejman Selimi, të premten është liruar me kusht nga burgu. Lajmi është konfirmuar nga avokati i tij, Tomë Gashi, i cili ka thënë se Selimi është mbajtur padrejtësisht mbi pesë vjet në burg. "Para pak minutash, pas mbajtjes pa të drejtë për mbi pesë vjet dhe pas mbajtjes në vuajtje të dënimit për 227 ditë pa vendim gjyqësor, më në fund është liruar gjeneral Sylejman Selimi", ka shkruar avokati Gashi në llogarinë e vet në "Facebook".

Lirimi i gjeneral Sylejman Selimit është mirëpritur nga familjarët, miqtë, bashkëluftëtarët dhe drejtuesit e institucioneve shtetërore e të partive politike. Pas daljes së Selimit nga burgu, presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka thënë se me gjeneralin Sylejman Selimi në liri, Kosova është më e mirë dhe më e sigurt. "Me heroin e gjallë, gjeneralin Sylejman Selimi në liri, Kosova është më e mirë dhe më e sigurt", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

Ndërsa kryetari i Kuvendit të Kosovës dhe kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka thënë se Sylejman Selimi është sinonim i të vërtetës së UÇK-së. "E vërteta mund të vonohet, por ajo gjithmonë triumfon. Sylejman Selimi është sinonim i të vërtetës së UÇK-së. Mirë se vjen, komandant!", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook".

Edhe kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka përshëndetur lirimin e gjeneral Sylejman Selimit. Ai ka thënë se heroi i luftës i është kthyer lirisë. "Heroi i luftës iu rikthye lirisë. Mirë së vjen, gjeneral Sylejman Selimi!", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Ndërsa kryetari i Nismës Socialdemokrate, njëherësh zëvendëskryeministri Fatmir Limaj, ka thënë se lirimi i Sylejman Selimit është lajmi i ditës. Ai ka uruar familjen e Selimit dhe të gjithë bashkëluftëtarët për lirimin e ish-komandantit të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. "Lajm i ditës, pa dyshim, lirimi i gjeneral Sylejman Selimit. Kosova mori lajmin e shumëpritur. Urime familjes së tij dhe gjithë bashkëluftëtarëve! Mirë se erdhe, gjeneral!", ka shkruar Limaj.

Kurse deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, Rexhep Selimi, ka thënë se pas shumë padrejtësive, ish-komandanti i UÇK-së, Sylejman Selimi, është liruar nga burgu. Ai ka thënë se edhe pse gjeneral Sylejman Selimi tashmë po kthehet, sistemi i drejtësisë në Kosovë i ka shumë borxhe atij. "Sot po kthehet gjenerali! Po kthehet në shtëpi, pranë familjes dhe miqve të tij. Po kthehet pas një lirimi me kusht, pasi tashmë i kaloi 2/3-tat e dënimit të padrejtë. Pas shumë padrejtësive ndaj tij, pas shumë vuajtjeve të familjes së tij, pas shumë problemeve shëndetësore, pas shumë kohe të kaluar padrejtësisht në burg, ai po kthehet në shtëpi. Por, edhe pse ai tashmë po kthehet, 'sistemi i drejtësisë' në Kosovë i ka shumë borxhe atij. Urime familjes, miqve dhe bashkëluftëtarëve!", ka shkruar Selimi në llogarinë e vet në "Facebook".

Edhe ish-komandanti i Zonës Operative të Drenicës, Sami Lushtaku, ka mirëpritur lirimin e Sylejman Selimit, duke thënë se tash Kosova frymon më lirshëm. "Mirë se vjen, gjeneral! Kosova tashmë frymon më lirshëm!", ka shkruar Lushtaku në llogarinë e vet në "Facebook".

Edhe ish-pjesëtari i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe ish-deputeti i Kosovës, Fadil Demaku, i është gëzuar lajmit për lirimin e ish-komandantit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Sylejman Selimi. Ai ka thënë se "Drenica 2" ka qenë proces i turpshëm për gjykatat e EULEX-it, por edhe për gjykatat vendore të cilat nuk kanë qenë në shërbim të drejtësisë. "Sot ndihem i gëzuar për Sylejman Selimin dhe familjen e tij që ka dalë në liri pas qëndrimit të tij më tepër se pesë vjet në burg nga procesi i quajtur 'Drenica 2'. Proces i turpshëm për gjykatat e EULEX-it, por edhe ato vendore të cilat në këtë rast nuk ishin në shërbim të drejtësisë, rast tashmë i njohur për të gjithë", ka shkruar Demaku në llogarinë e vet në "Facebook".

# Qalaj viziton kadetët policorë në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike

VUSHTRRI, 25 JANAR (ER) - Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës (PK), Rashit Qala, ka vizituar të premten Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (AKSP), me ç'rast në paradën e mëngjesit ka inspektuar kadetët e rinj të gjeneratës së 54-t. Drejtori Qalaj u ka dëshiruar mirëseardhje kadetëve të rinj, njëherësh i ka inkurajuar ta japin maksimumin e tyre për përfundimin me sukses të trajnimit, i cili pritet të zgjasë deri në shtator të vitit 2019.

Njëkohësisht është kërkuar nga kadetët të tregojnë angazhim, përkushtim dhe disiplinë të lartë gjatë trajnimit në akademi, për të arritur rezultate sa më pozitive si në anën profesionale, po ashtu edhe në atë të shkathtësive fizike. Implementimi i programeve dhe trajnimeve të dizajnuara në bazë të standardeve më të larta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe sundimit të ligjit do të jenë primare dhe obliguese për të gjithë në mënyrë që të arrihet profesionalizëm më i lartë në shërbim të vendit dhe qytetarëve. Vizita e drejtorit Qalaj dhe e zyrtarëve të lartë të PK-së, përfshirë edhe zyrtarin nga ICITAP-i amerikan, ka përfunduar pasi kanë përcjellë edhe një pjese të ligjëratës nga instruktorët policorë pran kadetëve.



Flet për "Epokën e re", gjenerallejtënant Rrahman Rama

# Ushtria po e thellon bas




Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, ka bërë me dije se pas fillimit të tranzicionit të FSK-së, ushtria vetëm po i thellon raportet me ShBA-në. Ai nuk beson që raportet e Qeverisë me ShBA-në për shkak të taksës për mallrat serbe do të mund të ndikojnë në bashkëpunimin e FSK-së me partnerët e saj strategjikë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se të gjitha përgjegjësitë dhe kapacitetet aktuale të FSK-së që dikur kanë qenë nën përgjegjësinë e KFOR-it, gradualisht po barten te FSK-ja. Gjenerallejtënant Rama ka bërë me dije se viti i parë i tranzicionit të FSK-së ka të bëjë më tepër me çështje administrative në ministri dhe për ndërtimin e Shtabit të Përgjithshëm, por edhe për ndërtimin e kapaciteteve trajnuese për misionin dhe mandatin e ri

EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 25 JANAR - **"Epoka e re"**: *Z. Gjeneral, sapo keni marrë edhe një mandat për ta drejtuar ushtrinë e Kosovës. Çfarë do të thotë kjo për ju?*

**Rama:** Për mua do të thotë shumë duke marrë për bazë fazën në të cilën gjendemi si ushtri e Kosovës. Është privilegj dhe nder, njëkohësisht përgjegjësi e madhe. Ne ka një kohë të gjatë që kemi punuar në këtë proces dhe tani veçse kemi filluar zbatimin e ligjeve të reja. Pra, prej 21 janarit kemi filluar tranzicionin tonë të brendshëm.

**"Epoka e re"**: *Cilat janë objektivat kryesore që synon t'i arrini brenda këtij mandati pesëvjeçar?*

**Rama:** Ne kemi një plan gjithëpërfshirës të cilin kemi ndërtuar me partnerët tanë. Ne do ta respektojmë atë plan. Mund të them se viti i parë ka të bëjë më tepër me çështje administrative të tranzicionit, qoftë në ministri apo për ndërtimin e Shtabit të Përgjithshëm, por edhe për

# hkëpunimin me ShBA-në



ndërtimin e kapaciteteve trajnuese për misionin dhe mandatin e ri që kemi. Normalisht se sa është e mundshme që të zhvillohemi, ne do të jemi të angazhuar dhe të përkushtuar, gjithashtu do t'i respektojmë edhe afatet kohore. Gjithmonë dëshira është e madhe, por mundësitë janë më të vogla. Duhet të merremi me çështjen e trajnimit dhe të personelit, pasi ky është prioriteti kryesor. Po ashtu, duhet të merremi edhe me pajisjet dhe infrastrukturën. Të gjitha këto janë elemente që mundësojnë zhvillimin e forcës. Ne kemi planin dhe çdo gjë e kemi të qartë. Do të ndërtojmë një forcë e cila do të jetë kredibile, mirë e trajnuar dhe e pajisur si duhet. FSK-ja do të jetë në shërbim të gjithë qytetarëve.

**"Epoka e re":** *Meqenëse tani ka filluar tranzicioni zyrtar i FSK-së në ushtri, cilat janë punët e para që po i bëni?*

**Rama:** Puna e parë që kemi bërë ka qenë zbulimi i pllakës, ku është ndryshuar emri prej ministrisë së FSK-së në Ministri të Mbrojtjes. Ne i kemi 120 ditë që janë më tepër punë administrative, si adaptimi i rregulloreve tona me ligjet e reja, në të njëjtën kohë është tranzicioni i ministrisë. Pra, struktura e re e ministrisë dhe struktura e re e Shtabit të Përgjithshëm. Pas 120 ditësh të tranzicionit ne do t'i kryejmë të gjitha obligimet administrative rreth tranzicionit të këtyre dy institucioneve, që janë bartëse të implementimit të planeve dhe objektivave tona që i kemi për të ardhmen.

**"Epoka e re":** *Pas këtyre 120 ditësh, kur do të mund të vërehet më shumë në opinion tranzicioni i FSK-së në ushtri?*

**Rama:** Në opinion do të vërehet shumë shpejt sepse në muajin e ardhshëm do ta kemi kampanjën e rekrutimit, ku do t'i marrim 650 rekrutë të ri. Gjysma e këtyre rekrutëve të rinj do të fillojnë në gjashtëmujorin e dytë të këtij viti, pastaj do të fillojnë trajnimet. Pjesa tjetër do t'i kryejë të gjitha obligimet, ku do të bëhet përzgjedhja, kurse trajnimet që janë të parapara do të fillojnë në janar të vitit të ardhshëm. Kjo bazuar edhe në planin tonë që ne duhet t'i kemi 2 800 trupa aktivë në vitin 2020. Në fakt, ne kemi qenë ushtri, por kemi pasur atë mangësinë ligjore. Natyrisht se në bazë të ligjeve të reja ne do të zhvillohemi. Trajnimet dhe ngritja profesionale janë shumë të rëndësishme për mandatin e ri. Por, kjo natyrisht se do kohë, trajnim, ekspertizë dhe përkrahje nga partnerët tanë. Paralelisht me këto ne do të shkojmë edhe me pajisje, por qëllimi kryesor është që ta përgatisim personelin që t'i përdorim pajisjet që do të kemi në bazë të mandatit të ri. Ne kot mund t'i blejmë pajisjet nëse nuk e kemi personelin e trajnuar që ato t'i përdorim.

**"Epoka e re":** *Kur do të fillojë pajisja e ushtrisë me armatimin që i takon sipas mandatit të ri?*

**Rama:** Do të fillojë këtë vit. Këtë vit kemi planifikimin tonë buxhetor, por këto janë çështje pak më të ndjeshme që nuk mund t'i themi të gjitha për publikun. Por, ne nga ky vit jemi në proces të ndryshimeve të rregulloreve dhe do të ketë mundësi dhe hapësirë që ta ruajmë standardin që kemi krijuar deri tani, qofshin ato në sistemin e armatimit, por edhe në automjetet taktike, të blinduara, infrastruktura që duhet të ndërtohet, depot etj. Ne kemi planifikimin e buxhetit, kemi objektivat tona, por kemi edhe planin e projekteve kapitale.

**"Epoka e re":** *Sfidë për ndërtimin e ushtrisë është përmendur puna e buxhetit. A do të keni buxhet të mjaftueshëm për këtë tranzicion?*

**Rama:** Planet tona janë të harmonizuara me të gjitha institucionet tona, duke përfshirë presidentin, kryeministrin dhe Qeverinë. Bazuar në planin tonë, ne kemi kërkuar prej Qeverisë që 5.5 milionë euro t'i kemi shtesë për çdo vit. Por, edhe planet tona që i përmenda më herët janë fleksibile, varësisht prej situatës dhe mundësive që do të vazhdojmë. Ne kemi përkrahjen e Qeverisë dhe shumë shpejt do të dalim me projekte konkrete dhe varësisht prej mundësive dhe kapaciteteve financiare ne do të furnizohemi.

**"Epoka e re":** *Prej fillimit të tranzicionit të FSK-së është ngrehur debati rreth raportit që tash e tutje do ta ketë kjo forcë me KFOR-in. Kur pritet t'i shqyrtoni raportet mes këtyre dy institucioneve?*

**Rama:** KFOR-i është në Kosovë në bazë të Rezolutës 1244. KFOR-i është partneri ynë dhe ne kemi një bashkëpunim të jashtëzakonshëm me të. Kemi pasur bashkëpunim edhe në të kuluarën, kurse tani vetëm sa e kemi thelluar këtë bashkëpunim. Në vitin 2009 është bërë transformimi i TMK-së në FSK dhe këto kapacitete i kemi ndërtuar bashkërisht me NATO-n, ndërkaq në vitin 2013 këto kapacitete janë njoftuar nga ana e NATO-s. Të gjitha këto kapacitete që i kemi aktualisht kanë qenë nën përgjegjësinë e KFOR-it në fillim dhe tashmë janë bartur gradualisht te ne. Edhe ky procesi tjetër, që jemi tani, gradualisht do të bartet. Ne do të jemi të koordinuar me KFOR-in, sepse është partneri ynë. Nuk është në interesin tonë që të kemi çështje të hapura me KFOR-in, duke marrë parasysh se na ka ndihmuar në kohët më të vështira dhe po vazhdon të na ndihmojë tani për ndërtimin e institucioneve demokratike të vendit. Ne do të jemi transparentë dhe gjithçka do ta bëjmë mbi bazën e koordinimit me aleatët tanë. Unë kam qenë në shumë kryeqytete të botës, duke përfshirë Uashingtonin dhe Brukselin. Qëllimi ynë ka qenë t'i njoftojmë partnerët tanë me planet, idetë dhe zhvillimet që planifikojmë t'i kemi në të ardhmen. Mbi bazën e kësaj transparence ne kemi marrë edhe përkrahjen e partnerëve tanë strategjikë gjatë procesit të tranzicionit.

**"Epoka e re":** *Për shkaqe që tashmë dihet, transformimi i FSK-së nuk u përkrah publikisht nga NATO-ja. A ka ndonjë ndryshim të raporteve në mes të NATO-s dhe FSK-së prej fillimit të mandatit të ri?*

**Rama:** Duhet ta kuptojmë se NATO-ja nuk njeh shtete. Vendet anëtare të NATO-s njohin shtete. Po ashtu, duhet ta kemi të qartë se NATO-ja, sa është organizatë ushtarake, është edhe organizatë politike. Dihet botërisht se si i merr vendimet. Fatkeqësisht, katër vende anëtare të NATO-s nuk e kanë njohur Kosovën. Ju siguroj se përkrahjen e NATO-s e kemi pasur nga fillimi. Këtë përkrahje e kemi edhe tani. Ne e kemi Ekipin Këshillues të NATO-s këtu në Kosovë, në ministri dhe në forcë. Pra, punojmë bashkërisht me ta. Ky bashkëpunim do të vazhdojë dhe vetëm do të thellohet pavarësisht prej atyre deklarimeve. Ne e kuptojmë edhe sekretarin e përgjithshëm të NATO-s, sepse ata duhet ta mbajnë një vazhdimësi të brendshme brenda organizatës, sepse çdo vendim i NATO-s duhet të ketë konsensus. Pra, ne nuk kemi asnjë çështje të hapur. E kemi pasur përkrahjen e tyre dhe do ta kemi edhe në të ardhmen.

**"Epoka e re":** *Domethënë, nuk ka kurrfarë ndryshimi të raporteve?*

**Rama:** Absolutisht. Vetëm janë shumë më të angazhuar dhe shumë më të interesuar që të na përkrahin në procesin e tranzicionit.

**"Epoka e re":** *Moslargimi i taksës për mallrat serbe flitet se mund të ndikojë në raportet Kosovë - ShBA. Është përmendur edhe mundësia e ndërprerjes së ndihmës amerikane për FSK-në. A i frikësoheni kësaj?*

**Rama:** Kjo është çështje politike. Mua nuk më takon ta komentoj. Por, nuk shoh se ka ftohje të bashkëpunimit të institucionit që përfaqësoj me partnerët e jashtëm. Ne kemi bashkëpunim të jashtëzakonshëm me ShBA-në. Jemi duke e bërë planin tri deri në pesë vjet se cilat do të jenë aktivitetet tona të përbashkëta me ShBA-në dhe me vendet e tjera që janë partnerë tanë. Ne kemi 14 marrëveshje bilaterale dhe jemi në proces edhe të pesë ose gjashtë marrëveshjeve të tjera. Në këtë drejtim nuk shohim ndonjë problem. Nuk ka asnjë ftohje të raporteve të FSK-së me ShBA-në. Përkundrazi, jemi duke e thelluar bashkëpunimin me këtë partner strategjik, gjithmonë duke marrë parasysh mandatin dhe misionin e ri që do ta kemi.

**"Epoka e re":** *Pra, deri më tani kjo nuk ka pasur ndonjë ndikim?*

**Rama:** Deri tani nuk kam parë indikacione të tilla dhe nuk guxojmë as të mendojmë se mund të vijmë në atë pozitë. Pra, nuk kam parë asnjë indikacion të ftohjes së raporteve, por për çdo ditë jemi duke u përkrahur më shumë. Jemi në fazën planifikuese për aktivitetet e përbashkëta që do t'i kemi. Nuk ka asnjë shqetësim për këtë çështje.

**"Epoka e re":** *Nuk besoni se këto çështje politike do të mund të ndikojnë në raportet e FSK-së me partnerët e saj?*

**Rama:** Jo. Nuk do të vijmë në atë pozitë. Të jeni të sigurt.

# Hoti: KQZ-ja po bllokohet me qëllim

Shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka thënë të premten, në një konferencë për media, se presidenti Hashim Thaçi është duke e bllokuar me qëllim emërimin e anëtarëve në KQZ. Ai ka thënë se nuk është në diskrecionin e tij të veprojë mbi baza të pazareve politike




EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 25 JANAR - Shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka mbajtur të premten konferencë, në të cilën ka folur për zhvillimet politike dhe ekonomike në vend. Duke folur për taksën 100 për qind ndaj produkteve të Serbisë, ai ka thënë se shteti i Serbisë meriton taksë shumë më të lartë se kjo që është vendosur. Por, sipas tij, kjo taksë është bërë strehimore për Qeverinë Haradinaj. "Për Qeverinë Haradinaj taksa 100 për qind është bërë strehimore për t'u ikur problemeve. Taksa po i mbulon dështimet e kësaj Qeverie: edhe grevën e arsimtarëve, edhe revokimet e njohjeve, edhe përçarjet rreth dialogut, edhe krizën e qeverisjes lokale në komunat në veri, edhe falimentimin e Telekomit, edhe rënien e investimeve të jashtme, edhe mosaprovimin e buxhetit për vitin 2019", ka thënë Hoti. Ai ka theksuar se kjo taksë është bërë çelës për t'i mbuluar problemet, por nuk po i zgjidh ato. "Sa më shumë që po përkeqësohet situata në Kosovë, duke u paralizuar institucionet një nga një, aq më shumë Qeveria po insiston në taksën 100 për qind. Përveç taksës 100 për qind, asgjë tjetër nuk mund të ofrojë koalicioni PAN për përmirësimin e gjendjes në Kosovë", ka thënë ai.

Ndërkaq duke folur rreth procesit të dialogut Kosovë - Serbi, ai ka thënë se kurrë nuk ka pasur më shumë paqartësi. "Vetëm një gjë është e sigurt, angazhimi i presidentit për shkëmbim të territoreve. Sa më shpesh që ekipi negociator po shkon në Bruksel, më i paqartë po bëhet në Prishtinë. Ekipi negociator tash i ka hequr tabutë për temat që do të dialogohen në Bruksel", është shprehur Hoti.

Ai ka komentuar edhe grevën në arsim dhe shëndetësi, duke theksuar se grevat vetëm sa po thellohen. "Është e qartë se Qeveria i ka shkaktuar këto greva me vendimin për dyfishim të pagës për vete. Zgjidhja është e qartë: (i) Qeveria ta anulojë vendimin për rritje të pagës për vete dhe (ii) Ligji i pagave të tërhiqet dhe të rishkruhet nga fillimi në konsultim me të gjitha kategoritë e punësuarve në sektorin publik", ka thënë ai.

Hoti në këtë konferencë për media ka folur edhe për mosemërimin e anëtarëve të KQZ-së ana e presidentit. "Ne vlerësojmë se me qëllim po bllokohet KQZ-ja tash e dhjetë muaj. Dhjetëra të zgjedhur nëpër kuvende komunale dhe një deputet i Kuvendit të Kosovës presin të certifikohen nga KQZ-ja. Presidenti e ka obligim kushtetues këtë gjë dhe nuk mund t'i ikë. Nuk është në diskrecionin e tij të veprojë mbi baza të pazareve politike. Ai duhet të veprojë vetëm në bazë të Kushtetutës, ndryshe do të përballet me Gjykatën Kushtetuese", ka deklaruar Hoti.

# Tahiri: Fuqia e grupeve kriminale në politikë e biznes dobësohet vetëm me konfiskimin e pasurisë




EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 25 JANAR - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, së bashku me shefen e Zyrës së BE-së në Kosovë, Nataliya Apostolova, dhe kryeprokurorin e Shtetit, Aleksandër Lumezi, kanë hapur të premten punëtorinë për Ligjin e ri për Kompetencat e Zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale, mbështetur nga projektit i BE-së: "Mbështetje e vazhduar institucioneve të Kosovës për luftimin e krimit të organizuar, korrupsionit dhe ekstremizmit të dhunshëm".

Punëtoria, e cila është pjesë e agjendës "Drejtësia 2020", sipas ministrit Tahiri, u mundëson organeve ligjzbatuese kuptimin sa më të mirë të normave ligjore që atyre u janë vënë në dispozicion për ta luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin.

Ministri Tahiri ka theksuar se konfiskimi i pasurisë së fituar me vepër penale ka qenë një ndër pikat më të dobëta të institucioneve, e kritikuar edhe në tri raporte për vendin të Komisionit Evropian, andaj dhe është punuar së bashku me BE-në për përmirësimin e legjislacionit dhe mekanizmave të nevojshëm për adresimin e kësaj çështje. "Tashmë Republika e Kosovës ka arritur të ketë një bazë ligjore, e cila hetuesve dhe prokurorëve tanë u jep mundësi dhe instrumente shtesë, që do ta nxjerrin shtetin tonë më mirë në ranglistën e shteteve që kanë pasur sukses për konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale. Pa dyshim, si qytetar i këtij vendi, presim që viti 2019 të jetë vit që do të japë rezultate shumë më të fuqishme sesa në vitet më parë", ka thënë ministri Tahiri.

Ai ka potencuar se në kuadër të Agjendës "Drejtësia 2020" do të mbikëqyret zbatimi i këtij ligji meqë rritja e numrit të gjyqtarëve, prokurorëve, bashkëpunëtorëve profesionalë dhe e hetuesve, e bënë më efikase luftën kundër krimit dhe korrupsionit. "Mendoj se mënyra më e mirë për ta dobësuar fuqinë e grupeve kriminale, qofshin në politikë apo në biznes, kudo që janë, është nëse ne arrijmë ta konfiskojmë pasurinë e tyre. Jam i bindur se këto grupe do të dobësohen dhe shteti do të dalë triumfues karshi tyre", ka theksuar ministri Tahiri.

Në Ligjin e ri për Kompetencat e Zgjeruara është shtuar numri i veprave penale për të cilat vlen konfiskimi, është zgjeruar konfiskimi jo vetëm për të pandehurin, por edhe për palët e treta nëse nuk janë blerës bona fide të asaj pasurie, si dhe është bërë sistem proporcional në dëshminë e barrës së provës. Sipas ligjit të ri, prokurori duhet të dëshmojë se pasuria e listuar për verifikim është pasuri e të pandehurit, ndërsa i pandehuri duhet të dëshmojë se atë pasuri e ka përfituar me burime të ligjshme, për të cilat duhet të ofrojë prova, në të kundërtën, ajo konfiskohet nga Gjykata.

# Ambasada e ShBA-së kërkon pezullimin e taksës

Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Prishtinë ka kërkuar pezullimin e menjëhershëm të taksës ndaj Serbisë. Në një deklaratë për medie kjo ambasadë ka vlerësuar se pezullimi i kësaj takse është një masë e nevojshme për ta rimëkëmbur momentumin në procesin e dialogut. Sipas ShBA-së, pengesat nga anash dhe refuzimi për t'i pezulluar tarifat janë kundër interesave të ShBA-së



EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 25 JANAR - Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Prishtinë nëpërmjet një deklarate për media ka kërkuar të premten pezullimin e menjëhershëm të taksës ndaj produkteve të Serbisë. Sipas ShBA-së, pezullimi i kësaj takse është një masë e nevojshme për ta rimëkëmbur momentumin në procesin e dialogut. "Thërrasim hisedarët nga Kosova dhe të tjerët nga rajoni që të tregojnë përkushtim ndaj normalizimit, paqes dhe stabilitetit rajonal dhe ndaj lëvizjes nëpër shtegun drejt integrimit evropian. Ne ritheksojmë pikëpamjen tonë se një pezullim i menjëhershëm i tarifës në importet nga Serbia dhe Bosnja është një masë e nevojshme për ta rimëkëmbur momentumin në procesin e Dialogut. Presim edhe nga hisedarët e tjerë t'i ndërmarrin masat e tyre konstruktive", është thënë në deklaratën e ShBA-së.

Ambasada e ShBA-së ka vlerësuar se pengesat nga anash dhe refuzimi për t'i pezulluar tarifat janë kundër interesave të ShBA-së. "Disa komentatorë dhe politikanë sugjeruan që statusi i Kosovës si shtet i pavarur dhe sovran, afërsisht i rreshtuar me Shtetet e Bashkuara, do ta mbrojnë atë nga të gjitha pasojat e vendimeve të tij në arenën ndërkombëtare. Ne këshillojmë kundër të supozuarit se Kosova apo cilido mik tjetër i Shteteve të Bashkuara mund të ndërmarrë veprime që janë kundër interesave tona strategjike pa u ballafaquar me pasojat për marrëdhënien tonë bilaterale", është thënë në deklaratën e Ambasadës së Amerikës.

Nëpërmjet kësaj deklarate, Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë bërë me dije se mbështesin plotësisht dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë të udhëhequr nga Bashkimi Evropian. "Një marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe me dobishmëri të ndërsjellë është në interesin strategjik të Shteteve të Bashkuara. Siç komunikoi presidenti Trump në letrën e tij presidentit Thaçi: 'Ju nxis juve dhe udhëheqësve të Kosovës që ta shfrytëzoni këtë moment unik, të flisni me zë të unifikuar gjatë bisedimeve të paqes dhe që të përmbaheni nga veprimet që mund ta bëjnë më të vështirë arritjen e një marrëveshjeje'", është theksuar më tutje në deklaratë. ShBA-ja ka inkurajuar të gjitha partitë politike që të kontribuojnë në mënyrë konstruktive në këtë proces. "Sikurse ka treguar edhe historia e re, Kosova është e suksesshme kur bashkohet nga brenda dhe hyn në partneritet me Shtetet e Bashkuara dhe BE-në. Ne inkurajojmë të gjitha partitë politike që të kontribuojnë në mënyrë konstruktive në këtë proces. Veprimet që minojnë dialogun, pengesat nga anash dhe refuzimi për t'i pezulluar tarifat - gjitha këto shkojnë kundër interesave të ShBA-së. Ajo çka është e nevojshme tani është një lidership i guximshëm për t'i promovuar qëllimet tona të përbashkëta. Kjo është ajo që na ndihmon neve për të mbajtur një marrëdhënie të fortë bilaterale", është theksuar në deklaratën e Ambasadës së ShBA-së.

Por ndaj kësaj deklarate ka reaguar kryeministri Ramush Haradinaj, i cili ka thënë se Kosova është e interesuar ta pezullojë taksën vetëm nëse ka gatishmëri nga Serbia për ta njohur pavarësinë e Kosovës. "Jo, nuk ka diçka të kësaj natyre. Ne kemi hyrë në disa dimensione të reja në politikë në Kosovë. Do të thotë, këtë vit shumicën e kohës do t'ia kushtojmë ekonomisë. Marrëdhëniet ekonomike Kosovë - Serbi janë të rëndësishme, ndonjëherë kanë për t'u rregulluar, por duhet për t'u prirë edhe marrëdhëniet politike. Pra, pa një marrëveshje politike Kosovë - Serbi është zor për t'i rregulluar marrëdhëniet e tjera. Ne jemi të hapur dhe të interesuar për ta pezulluar taksën nëse ka gatishmëri për t'u rregulluar marrëdhëniet Kosovë - Serbi, që nënkupton edhe njohja e Kosovës", ka deklaruar Haradinaj pas vizitës në kompaninë "M-Technologie".

# SBAShK-u nuk tërhiqet nga greva

PRISHTINË, 25 JANAR (ER) - Sindikata e Bashkuar e Arsimit, e Shkencës dhe e Kulturës (SBAShK) ka njoftuar se raportet e arritura nga Këshilli Qendror Grevist, komunal dhe universitetet, tregojnë se edhe në ditën e dhjetë të punësuarit në tërë sektorin e arsimit të Kosovës ishin në grevën e tyre. Sipas SBAShK-ut, greva do të vazhdojë deri në realizimin e kërkesave për ndryshim të koeficienteve në tërë sektorin e arsimit. "Sot ministri Bytyqi ka ftuar në një takim përfaqësuesit e SBAShK-ut, për të debatuar për gjendjen aktuale në sistemin arsimor. Ai është deklaruar se do të angazhohet që në të ardhmen koeficientet të ngrehën pasi të jetë bërë performanca dhe gradimi i punëtorëve të arsimit, por nuk ka dhënë ndonjë zgjidhje për koeficientet aktualë të cilët mbeten shumë të ulët në sektorin e arsimit, ku për këtë propozim është biseduar me kryetarët komunalë të sindikatave dhe me anëtarët e Këshillit Drejtues të SBAShK-ut të cilët me këmbëngulësi kërkojnë që koeficienti aktual të rritet sipas kërkesave, aq më tepër duke pasur parasysh që koeficientet, edhe nëse mbeten deri në 10, është përsëri koeficienti i arsimit në fund të tabelës", është bërë me dije në njoftimin e SBAShK-ut.

Kryetari i SBAShK-ut, Rrahman Jasharaj, është shprehur se është çasti i fundit që duhet bërë zgjidhje për ngritjen së paku të 30 për qind të koeficienteve për tërë sektorin e arsimit, nga çerdhet deri në universitete në Projektligjin e pagave. Sipas tij, pasi të bëhet kjo zgjidhje atëherë mund të flitet se çfarë do të bëhet në sistemin arsimor në të ardhmen.



# Kontratat e negociuara me kosto më të lartë se kontratat me procedurë të hapur

Në mungesë të analizave të mjaftueshme, vlerësimit të nevojave dhe njohjes së tregut, autoritetet kontraktuese kanë lidhur marrëveshje kontraktuese nëpërmjet procedurës së negociuar e cila në disa raste kishte rezultuar me kosto më të lartë për shërbimet/mallrat e pranuara sesa kontratat paraprake me procedurë të hapur apo mundësitë që ishin në treg



EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 25 JANAR - Zyra Kombëtare e Auditimit ka publikuar Raportin e auditimit të performancës "Procedura me negocim pa publikim të njoftimit për kontratë". Auditimi ka evidentuar që përdorimi i procedurës së negociuar pa publikim të kontratës nuk ishte arsyetuar mjaftueshëm dhe autoritetet kontraktuese nuk i kishin shteruar të gjitha mundësitë për ta shmangur përdorimin e kësaj procedure. Raporti thekson se asnjë nga autoritet kontraktuese të audituara nuk kishin bërë analiza të përfitimeve dhe kostove pas zbatimit të kontratave dhe kështu nuk kanë bazë mbi të cilën do të mund t'i merrnin vendimet për blerjet e radhës.

Rreth 65 për qind e kontratave të audituara nëpërmjet procedurës së negociuar ishin lidhur në kushte minimale të konkurrencës, prej tyre afër 47për qind me vetëm një operator ekonomik dhe 18 për qind e tyre me vetëm dy operator ekonomik. Kjo mënyrë e prokurimit të mallrave dhe shërbimeve si dhe punëve nuk është transparente dhe nuk garanton se autoriteti kontraktues ka marrë vlerë për paranë që ka shpenzuar. Me disa përmirësime në aspektin e hulumtimit të tregut dhe të analizës së kontratave paraprake, autoritetet kontraktuese të audituara do të mund të siguronin konkurrencë më të lartë dhe çmime më ekonomike.

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm, me rastin e publikimit të këtij raporti, ka potencuar se "autoritetet kontraktuese duhet të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për ta ulur përdorimin e procedurës së negociuar pa publikim, në mënyrë që prokurimet të jenë transparente dhe ta sigurojnë konkurrencë, rrjedhimisht edhe çmime më ekonomike".

Konkluzionet e lartcekura janë si rezultat i auditimit të 17 aktiviteteve të prokurimit të zhvilluara me procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë në katër autoritete kontraktuese: Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, Doganën e Kosovës dhe Sekretariatin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Vlera e përbashkët e këtyre kontratave është mbi 21 milionë euro.

Zyra Kombëtare e Auditimit ka rekomanduar institucionet e audituara që të zhvillojnë hulumtim të tregut për t'i identifikuar furnizuesit potencial dhe ofertën e tyre, të bëjnë vlerësim të duhur të nevojave dhe të shqyrtojnë produkte alternative. Gjithashtu, duhet të bëjnë një analizë të përfitimeve dhe kostove pas zbatimit të secilës kontratë në mënyrë që vendimet e ardhshme për blerje të jenë të bazuara në informata të qëndrueshme që të sigurojnë çmime më ekonomike.



# Veseli takoi përfaqësuesit e odave ekonomike, u premton mbështetje

PRISHTINË, 25 JANAR (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka pritur të premten në një takim drejtuesit e odave ekonomike, të bizneseve, të prodhuesve si dhe të shoqatave të tjera nga fusha e ekonomisë.

Me këtë rast, Veseli ka premtuar mbështetje për bizneset vendore. Ai ka thënë se mbështetja për bizneset është mbështetje për ushtrinë dhe çdo segment tjetër i shtetit të Kosovës.

Ishte konstatim i përbashkët i përfaqësuesve të institucioneve ekonomike, se Kuvendi duhet të miratojë ligje edhe më favorizuese për bizneset, për eksport dhe për investime të cilat do të gjenerojnë vende të reja të punës.

Në këtë takim është arritur pajtueshmëri që të funksionalizohet Zyra e Komunitetit të Bizneseve brenda Kuvendit të cilën do të drejtojë kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi. Për të gjetur modalitete të reja në mbështetje të bizneseve vendore, javën e ardhshme do të mbahet një konferencë pune, në të cilën do të marrë pjesë kryeparlamentari Veseli dhe përfaqësuesit e institucioneve ekonomike vendore.

# Qeveria dhe Komisioni për Zhvillim miratuan draftin e ri të statutit të 'Trepçës'

Statuti i shoqërisë aksionare "Trepça" përcakton themeluesit e shoqërisë aksionare, aksionet e tyre, veprimtarinë, strukturën organizative, kapitalin themeltar, menaxhimin, afarizmin dhe të gjitha çështjet organizative që lidhen me kompaninë. Emërtimi i shoqërisë aksionare është "Trepça" sh. a. dhe selia e saj është në Parkun Industrial të Mitrovicës

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 25 JANAR - Qeveria e Kosovës në mbledhjen e së premtes ka miratuar projekt-statutin e Shoqërisë Aksionare "Trepça", i propozuar nga Bordi Mbikëqyrës. Versioni i ri i projekt-statutit dërgohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Statuti përcakton themeluesit e shoqërisë aksionare, aksionet e tyre, veprimtarinë, strukturën organizative, kapitalin themeltar, menaxhimin, afarizmin dhe të gjitha çështjet organizative që lidhen me kompaninë.

Emërtimi i shoqërisë aksionare është "Trepça" sh. a. dhe selia e saj është në Parkun Industrial të Mitrovicës. Miratimi statusit të shoqërisë aksionare "Trepça" sh. a. do ta mundësojë zbatimin e Ligjit për Trepçën dhe versioni i miratuar sot është në pajtueshmëri të plotë nga të gjithë aktorët që ndikohen nga kjo kompani. Edhe Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal me shumicë votash ka miratuar të premten draft-statutin për "Trepçën", i cili pritet të votohet seancën e 31 janarit.

Deputetja e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Hykmete Bajrami, ka pyetur ministrin e Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, lidhur me fabrikën e pajimeve dhe përfshirjen e këtij aseti në statut. "Unë kam lexuar që fabrika e pajimeve nuk është përfshirë. A është përfshirë ky aset? Dhe çfarë do të ndodhë me listën e aseteve që AKP-ja ka bërë një inventar", ka pyetur ajo.

Ndërkaq ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka thënë se draftstatuti i "Trepçës" do të jetë i ndryshueshëm në mënyrë që t'i përshtatet zhvillimit të kësaj ndërmarrje. "Fillimisht kam deklaruar se fabrika e pajimeve ka qenë jashtë, por ajo tash është e përfshirë në draft-statut. Statuti është dokument që mund të ndryshohet. Nuk është dokument që ka për të pasur vështirësi në ndryshimin e saj. Aseteve ka për t'iu bërë një vlerësim nga një kompani e jashtme e pavarur", ka thënë Lluka.

## Syla apelon për konsensus politik për draft-statutin final të "Trepçës"

Kryesuesi i Bordit të "Trepçës", Ardian Syla, pas dhënies së dritës jeshile të premten në Qeverinë e Kosovës dhe në Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, ka thënë se ky vendim paraqet progres për "Trepçën". Ai ka thënë se në mbledhjen e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal u hap rruga për dërgimin e statutit të "Trepça", sh. a. për në seancën plenare të Kuvendit të Kosovës, pas rekomandimit pozitiv të dhëna nga të gjithë deputetët e këtij komisioni. "Pas këtij votimi ka mbetur vetëm edhe një hap deri në funksionalizimin e plotë të 'Trepça', sh. a., e që është votimi i statutit të 'Trepça' sh. a. nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, procedurë kjo e paraparë me Ligjin për 'Trepçën'", ka thënë Syla. Ai ka falënderuar anëtarët e Bordit Mbikëqyrës, Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Komisionin për Zhvillim Ekonomik për këtë angazhim rreth draftstatutit. "Apeloj që të ketë konsensus të plotë nga të gjitha grupet parlamentare gjatë votimit të draftstatutit në Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e paraparë për miratim të statutit të 'Trepça sh. a.'", ka shkruar Syla në llogarinë e vet në "Facebook".




## LB-ja kërkon që të rishikohen koficientet e ligjit të pagave



PRISHTINË, 25 JANAR (ER) - Kryetari i Lëvizjes për Bashkim (LB), Valon Murati, ka thënë të premten se greva e arsimtarëve është duke e përmbyllur javën e dytë dhe zgjidhja nuk po duket në horizont. "Kërkesat e arsimtarëve janë të drejta, ashtu siç është e vërtetë se nxënësit po dëmtohen shumë në këtë situatë. Oferta e Qeverisë për rritje të pagave ishte e pamjaftueshme, sidomos nën dritën e rritjes së pamenduar të pagave për vetveten, numrit enorm të ministrave, zëvendësministrave e të stafit tjetër përcjellës edhe vështirë e pranueshme jo vetëm nga arsimtarët, por edhe nga shoqëria", ka shkruar Murati në llogarinë e vet në "Facebook". Ai ka thënë se kjo dëshmon se si një veprim i pamenduar qeveritar mund të shkaktojë një kaos zinxhiror në funksionimin e tërë hallkave të shtetit dhe shoqërisë. "Duke qenë se kjo çështje duhet të zgjidhet me Ligjin për pagat, e ky ligj është në procedura parlamentare, ftoj të gjithë aktorët të përfshihen në një dialog të thellë social. Qeveria, të gjitha partitë parlamentare, pozitë dhe opozitë, si dhe SBAShK-u të fillojnë një dialog i cili do të rezultonte me rishikimin dhe balancimin e koeficienteve, me ç'rast do të rriteshin ato për arsimtarët, mjekët etj. dhe do të zvogëloheshin për qeveritarët. Fillimi i këtij dialogu do të duhej të përcillej me ndërprerjen e grevës", ka thënë Murati.

# Hapet thirrja për mbështetje financiare të bizneseve në Skenderaj

SKENDERAJ, 25 JANAR (ER) - Në sallën e Kuvendit Komunal të Skenderajt është mbajtur sesioni informues me qytetarë, ku është hapur thirrja për aplikim për mbështetje financiare, për bizneset e reja dhe ato ekzistuese, nga granti i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal. Kryetari i Skenderajt, Bekim Jashari, u ka bërë thirrje qytetarëve të aplikojnë me projekt-propozime për hapje të bizneseve. "Ju inkurajoj të gjithëve që keni ide për hapje të biznesit, që ta shfrytëzoni këtë mundësi dhe të aplikoni për përkrahje financiare nga Ministria e Zhvillimit Rajonal", është shprehur Jashari.
Qëllimi i kësaj thirrjeje është zhvillimi socio-ekonomik rajonal përmes zhvillimit të ndërmarrësisë. Ministria e Zhvillimit Rajonal synon që përmes granteve t'i mbështesë bizneset e reja dhe ato ekzistuese, që synojnë krijimin e vendeve të reja të punës dhe rrjedhimisht zvogëlimin e papunësisë për të rinjtë e Skenderajt.






# Më 30 janar në Junik mbahet akademi përkujtimore për Edmondin, Zahirin dhe Hakifin

JUNIK, 25 JANAR (ER) - Me rastin e 22-vjetorit të rënies së heronjve të kombit: Edmond Hoxha, Zahir Pajaziti dhe Hakif Zejnullahu, nën përkujdesjen e kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj, dhe nën organizimin e Komunës së Junikut, më 30 janar, në orën: 11:00, në sallën e Kuvendit Komunal të Junikut do të mbahet akademi përkujtimore për tre heronjtë. Të pranishëm në këtë akademi do të jenë kryeministri Ramush Haradinaj dhe kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli.

# Policia konfiskon mbi 50 kilogramë narkotikë, arreston tre persona

PRISHTINË, 25 JANAR (ER) - Policia e Kosovës ka arrestuar tre persona të dyshuar dhe ka konfiskuar më shumë se 50 kilogramë substancë të dyshuar narkotike.
Drejtoria për Hetimin e Trafikimit të Narkotikëve në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë në Prishtinë ka bërë me dije se operacioni është ndërmarrë pas një hetimi disamujorë. Aksioni i Policisë është zhvilluar në dy lokacione. "Në rrugën Prishtinë - Gjilan (në fshatin Ponesh) Policia e Kosovës ka ndaluar automjetin Mercedes me targa shqiptare, që drejtohej nga i dyshuari (F. Th.), i cili ishte së bashku me të dyshuarin tjetër (Xh. H.), të dy meshkuj me shtetësi shqiptare dhe pas proceduarve të kontrollit në bagazhin e automjetit në fjalë është gjetur një sasi prej mbi 52 kg, sasi e dyshuar e substancës narkotike e llojit marijuanë", është thënë në njoftimin për media.
Po të enjten, sipas njoftimit të Policisë, rreth orës 19:30, në Gjilan është arrestuar i dyshuari i tretë (L. M.) me shtetësi serbe, i cili dyshohet se kishte për ta pranuar substancën narkotike të lartcekur. Ndërkaq, pos lëndës narkotike, si prova materiale janë sekuestruar: dy vetura, katër telefona celularë, dy mijë euro para kesh. Me vendim të prokurorit kompetent të dyshuarit janë dërguar në mbajtje për procedura të mëtejme ligjore.



# Komuna e Kaçanikut është e gatshme për të aplikuar në fondet e Qeverisë japoneze

Kryetari Ilazi ka theksuar se prioritet i kësaj komune mbetet menaxhimi i mbeturinave, duke shtuar se interesimi i tyre është që të aplikojnë për grante në këtë fushë

KAÇANIK, 25 JANAR (ER) - Kryetari i Komunës së Kaçanikut, Besim Ilazi, ka pritur në takim përfaqësuesin e Ambasadës së Japonisë në Kosovë, asistentin e granteve për projekte, Mark Rodiqi. Kryetari Ilazi fillimisht ka shprehur falënderimet për përkrahjen e Qeverisë japoneze dhënë Komunës së Kaçanikut në sektorin e shëndetësisë. Ai ka thënë se Komuna e Kaçanikut do të aplikojë në grantet e Qeverisë japoneze, duke shprehur përkushtimin profesional të stafit ekzekutiv dhe administrativ për kompletim të dokumenteve të nevojshme.
Kryetari Ilazi ka theksuar se prioritet i kësaj komune mbetet menaxhimi i mbeturinave, duke shtuar se interesimi i tyre është që të aplikojnë për grante në këtë fushë. Vitin e kaluar Qeveria japoneze i ka dhuruar donacion Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Kaçanik një autoambulancë dhe një minibus për bartjen e pacientëve me dializë.



# 2019-ta, vit i ekonomisë dhe punësimit

2019-ta është shpallur vit i ekonomisë dhe ashtu do të jetë sepse ne do të fokusohemi në krijimin e kushteve, në rend të parë për bizneset vendore, përmirësimin e ambientit e të bërit biznes në vend e gradualisht do të fokusohemi edhe në tërheqjen e investimeve të huaja, pasi që si vend kemi kapacitete të mëdha jo vetëm në fushën e energjisë, por edhe në fusha të tjera



Gazmend ABRASHI

Ndryshimi në Kosovë ka ndodhur më 9 shtator të vitit 2017, saktësisht para rreth një viti e gjysmë me ardhjen e Ramush Haradinajt në krye të Qeverisë së Kosovës. Po ashtu, bashkë me ardhjen e tij, ka ndryshuar edhe mentaliteti qeverisës, nga një mentalitet jodinamik, në një mentalitet tepër dinamik, duke u karakterizuar me një qeveri të gatshme për marrjen e vendimeve dhe veprimeve të shpejta dhe konkrete për fusha dhe çështje të ndryshme. Dihet se në fillim si Qeveri e Kosovës jemi përballur me disa procese politike, të cilat i kanë shoqëruar qeveritë e kaluara nga viti në vit, duke mos u gjetur zgjidhje për to. Temat, të cilat kanë marrë kohë dhe është investuar mund i madh, është edhe ajo për ratifikimin e Marrëveshjes për Demarkacionin e Kufirit në mes të Republikës së Kosovës dhe Malin e Zi, e cila ishte bllokuar për një kohë të gjatë. Po ashtu, një pjesë të punës sonë e ka dominuar edhe dialogu dhe temat rreth dialogut mes Republikës së Kosovës dhe Serbisë në Bruksel. Tashmë për këto bisedime vendi ynë ka një ekip negociator me përfshirjen edhe të opozitës.

Përfundimi i demarkimit të kufirit me Malin e Zi ka bërë që e gjithë puna në kabinetin e kryeministrit Haradinaj dhe në gjithë Qeverinë e Kosovës të orientohet në shtimin e agjendës ekonomike.

Se 2019-ta është shpallur vit i ekonomisë e ka thënë edhe kryeministri Haradinaj dhe ashtu do të jetë sepse ne do të fokusohemi në krijimin e kushteve, në rend të parë për bizneset vendore, përmirësimin e ambientit e të bërit biznes në vend e gradualisht do të fokusohemi edhe në tërheqjen e investimeve të huaja, pasi që si vend kemi kapacitete të mëdha jo vetëm në fushën e energjisë, por edhe në fusha të tjera.

Fillimi i punës për ndërtimin e Termocentralit "Kosova e Re" i parashikuar për në mars të këtij viti, me një kapacitet prej 500 megavatëve, si dhe investimi prej 1.3 miliard eurosh deri në vitin 2023, kur edhe pritet të funksionalizohet do të kishte impute të madh për ekonominë. Me fillimin e investimeve në projektin më të madh në vend, përveç punësimit të qytetarëve të Kosovës, ky proces do të ishte edhe një mesazh i mirë për investitorët e huaj, të cilëve përmes kësaj iu dëshmojmë se si Kosovë dhe Qeveri e Kosovës, kemi kushte dhe potencial të madh për investime. Po ashtu, përfundimi i këtij projekti do ta bënte Kosovën vend, me një imazh të sigurt dhe stabil në sytë e të gjithë investitorëve të huaj.

Se këtë vit priten investime të reja e dëshmon edhe Ligji për Investime Strategjike, i cili në mënyrë specifike trajton dhe ua lehtëson punën investitorëve të cilët dëshirojnë të investojnë në vendin tonë. Tashmë janë 11 investitorë strategjikë në kualifikim e sipër dhe gati dy miliardë euro investime, ku shumica e tyre janë të interesuar për të investuar në sektorin e energjisë, transportit, turizmit dhe fusha të tjera.

### Fuqizimi i bizneseve vendore

Si Qeveri e Kosovës nga fillimi i mandatit i kemi pasur në fokus të veçantë bizneset vendore, por gjatë këtij viti do ta kemi një fokus më të madh te bizneset, të cilat merren me prodhim, duke kontribuar kështu edhe në rritjen e punësimit në vend.

Në fuqizimin e bizneseve, por edhe në rritjen e punësimit dhe të prodhimit ka ndikuar edhe taksa prej 100 përqindësh për produktet me origjinë nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina, si shenjë pakënaqësie për pengesat që u bëhen bizneseve të Kosovës, por edhe paralajmërim se Republika e Kosovës ka institucione dhe mund ta mbrojë vendin dhe bizneset e veta.

Si Qeveri, por edhe si biznese duhet të angazhohemi më shumë për ta ulur shkallën e papunësisë, e cila në vendin tonë, sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, arrin në afër 30 për qind. Po ashtu, duhet ta rrisim prodhimin vendor që dallimet mes eksporteve dhe importeve mos të jenë kaq të mëdha, si dhe të angazhohemi që paraja e gatshme të investohet në vendin tonë, e jo të vazhdojë të eksportohet jashtë vendit.

Rritja e buxhetit për vitin 2019, në shumën prej mbi 2.3 miliardë eurosh, do të ndikojë edhe në një rritje më të madhe ekonomike gjatë këtij viti, e cila, sipas parashikimeve tona, mund të shkojë edhe në deri në rreth 5 për qind, e cila nuk është e mjaftueshme për gjendjen në të cilën jemi, por si Republikë e Kosovës do ta kemi rritjen më të madhe ekonomike në krahasim me vendet e rajonit.

Buxheti për vitin 2019, i cili shumë shpejt pritet të kalojë në Kuvendin e Kosovës, mundëson një funksionim të mirë të shtetit, siguron përkrahje për të gjitha kategoritë nga arka e shtetit e, po ashtu, siguron edhe financim të projekteve ekzistuese infrastrukturore si dhe projekteve të reja kapitale. Pra, nuk na mbetet tjetër vetëm të punojmë fort dhe të angazhohemi të gjithë me krejt kapacitetet intelektuale e institucionale, por edhe biznesore dhe qytetare, që ta bëjmë edhe në realitet vitin 2019, vit të ekonomisë dhe punësimit.

**(Autori është Koordinator Nacional për Ballkanin Perëndimor - BP6 dhe Këshillin për Bashkëpunim Rajonal - KBR)**

# Haradinaj: Kemi nevojë për investime të huaja në Kosovë

**Prishtinë, 25 janar (ER)** - "Kemi nevojë për investime të huaja në Kosovë, por investimet e huaja i sjellin shembujt e suksesshëm të investitorëve tanë, sikur rasti i 'M-Technologie'. Ky vërtet është një shembull i suksesshëm", kështu ka thënë të premten kryeministri Ramush Haradinaj gjatë një vizite pune që ka zhvilluar në fabrikën e prodhimit dhe përpunimit të xhamit "M-Technologie", ku është pritur nga drejtori i kësaj fabrike, Rrustem Pacolli, me bashkëpunëtorë.



Kryeministri Haradinaj ka thënë se kjo fabrikë është më e mira e kësaj natyre jo vetëm në Kosovë, por ndër më të mirat në Evropë dhe botë. "Shohim parametra më të mirë të mundshëm në këtë teknologji. Prodhimet e kësaj kompanie arrijnë dhe janë të pranuara në të gjitha tregjet e botës", është shprehur kryeministri Haradinaj.

Duke përgëzuar për punën që bën dhe për 200 të punësuar, kryeministri Haradinaj ka thënë se "M-Technologie" është ndër nëntë eksportuesit më të mëdhenj të vendit. "Jam i inkurajuar me punën që bëjnë, edhe pse kanë disa vështirësi, siç është ajo me ngrohjen e hapësirës së kompanisë, e cila ka mbi 20 mijë metra katrorë", ka thënë Haradinaj, duke shtuar se është bërë lirimi në lëndën e parë dhe në pajisjet për prodhim, por nuk është arritur të bëhet lirimi për mazutin dhe se edhe ky aspekt do të trajtohet me kujdes. Po ashtu, kryeministri Haradinaj ka thënë se, duke qenë një kompani e cila po ecën sigurt përpara, Qeveria do të jetë pranë saj në çdo kohë. Drejtori i kësaj fabrike, Rrustem Pacolli, ka falënderuar kryeministrin Haradinaj për vizitën që i ka bërë kompanisë, duke thënë se kjo tregon për mbështetjen e madhe dhe gatishmërinë e kryeministrit për të qenë afër bizneseve të vendit.

## Arrestohet Roger Stone, bashkëpunëtor i presidentit Trump



UASHINGTON, 25 JANAR - Roger Stone, një bashkëpunëtor i presidentit të Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, është arrestuar të premten nën akuzat për veprimtari kriminale që po i zhvillon këshilltari i posaçëm, Robert Mueller. Arrestimi i Stone u bë pasi ndaj tij u ngrehën shtatë akuza, njoftoi zyra e këshilltarit, Mueller.
Stone, një bashkëpunëtor dhe këshilltar i fushatës së presidentit amerikan Trump, përballet me një akuzë për pengimin e një procedimi zyrtar, pesë akuza për deklarata të rreme dhe një akuzë për manipulimin e dëshmitarëve. Megjithatë, ai nuk akuzohet për bashkërendim me zyrtarë rusë, të cilët pretendohet se kanë ndërhyrë në zgjedhjet presidenciale të vitit 2016 në ShBA. Këto pretendime janë çështja kyçe me të cilën po merret këshilltari i posaçëm Robert Mueller.

# Parlamenti grek ratifikon Marrëveshjen për emrin e Maqedonisë

Pasi Parlamenti grek ka ratifikuar marrëveshjen me Maqedoninë për zgjidhjen e kontestit të emrit, kjo e fundit e ka ndërruar emrin në Maqedoni e Veriut, ndërsa Shkupi ka pranuar se gjuha maqedonase është pjesë e grupit të gjuhëve sllave dhe se identiteti nuk ka asgjë të përbashkët me maqedonasit e lashtë


Michael Varaklas (AP)

ATHINË, 25 JANAR - Parlamenti i Greqisë ka ratifikuar marrëveshjen me Maqedoninë për zgjidhjen e kontestit të emrit. Për marrëveshjen kanë votuar 153 deputetë nga 300 sa numëron institucioni ligjvënës në Athinë. Kundër kanë votuar 146 deputetë të opozitës, ndërsa asnjë votë abstenim. Votimit i ka paraprirë një debat treditor i përcjellë me akuza të shumta mes deputetëve të partisë së kryeministrit grek, Aleksis Tsipras dhe atyre të Demokracisë së Re, të cilët marrëveshjen e vlerësonin të dëmshme. Janë mbajtur edhe protesta të shumta nga grupe të ndryshme, të cilat të enjten në mbrëmje dogjën edhe flamurin maqedonas.
Pas votimit të marrëveshjes, Parlamenti grek duhet t'i njoftojë shtetet anëtare të NATO-s se tërhiqet nga bllokimi i pranimit të Maqedonisë në NATO. Me këtë marrëveshje, Maqedonia e ka ndërruar emrin në Maqedoni e Veriut, ndërsa Shkupi ka pranuar se gjuha maqedonase është pjesë e grupit të gjuhëve sllave dhe se identiteti nuk ka asgjë të përbashkët me maqedonasit e lashtë.
Marrëveshja ishte nënshkruar më 17 qershor 2018 në Prespë, me të cilën edhe mbyllet kontesti 27-vjeçar ndërmjet dy vendeve. Pas ratifikimit të marrëveshjes nga Parlamenti i Greqisë, kryeministri i Maqedonisë ka përgëzuar homologun e tij grek, Aleksis Tsipras.
"Gëzuar miku im, Aleksis Tspiras! Së bashku me popujt tanë shkruam fitore historike. Le të jetë e përjetshme Marrëveshja e Prespës. Le të jenë të përjetshme paqja dhe progresi në Ballkan dhe Evropë", ka shkruar Zaev në rrjetin social "Facebook".
Edhe zëvendëskryeministri për Çështje Evropiane i Maqedonisë së Veriut, Bujar Osmani, vendimin e Parlamentit grek e ka vlerësuar shumë të rëndësishëm për të ardhmen e të dy vendeve, ndërsa kryeministrin grek Tsipras e ka përgëzuar për guximin, vizionin dhe durimin e treguar për procesin e ratifikimit të marrëveshjes. "Urime për të gjithë ne, mirënjohje për qytetarët e dy vendeve. Ballkani sot fitoi dy fqinjë, miq të shkëlqyer, shembull për të gjitha vendet e tjera të Ballkanit", ka thënë Osmani.

# NATO-ja paralajmëron Rusinë




BRUKSEL, 25 JANAR - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, paralajmëroi të premten se Rusia nuk po jep ndonjë shenjë se do t'i respektojë kushtet e një traktati të rëndësishëm lidhur me raketat, të epokës së Luftës së Ftohtë dhe se e ardhmja e paktit është në rrezik, ndërsa Shtetet e Bashkuara po përgatiten të largohen nga traktati javën e ardhshme. "Tashmë traktati është në rrezik dhe, për fat të keq, nuk kemi parë ndonjë shenjë të ndonjë ndryshimi të rëndësishëm", u tha gazetarëve Stoltenberg pasi kryesoi bisedimet NATO - Rusi në Bruksel.
Traktati i forcave bërthamore me rreze të mesme veprimi i vitit 1987 ndërmjet Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Sovjetik ndalon prodhimin, testimin dhe dislokimin e raketave tokësore dhe atyre balistike të afta për të përshkruar distanca nga 500 në 5 500 kilometra.
Në informacionin që Pentagoni ka ndarë me aleatët e NATO-s pohon se sistemi i ri raketor i Rusisë "9M729" shkel kushtet e traktatit. Besohet se raketat që disponon Rusia i japin mundësinë asaj të nisë një sulm bërthamor në Evropë duke dhënë sinjale të zbehta ose fare pa paralajmërim. Moska insiston se raketat kanë aftësinë të përshkojnë distanca më të vogla se 500 kilometra.
Në muajin tetor presidenti Donald Trump paralajmëroi se Shtetet e Bashkuara do ta braktisnin traktatin për shkak të dyshimeve se Rusia po e shkel atë. Nëse Moska nuk do t'u përmbahet kushteve të tij, Uashingtoni do ta nisë procesin gjashtëmujor të largimit nga pakti duke filluar prej 2 shkurtit.

## Kriza në Venezuelë, ShBA-ja do të kërkojë nga KS i OKB-së njohjen e Guaidos

UASHINGTON, 25 JANAR - Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, do t'u kërkojë vendeve anëtare të Këshillit të Sigurimit të OKB-së ta njohin udhëheqësin e opozitës Juan Guaido si president i përkohshëm i Venezuelës gjatë një takimi urgjent që do të mbahet sot (e shtunë), ka njoftuar Departamenti i Shtetit. "Sekretari Pompeo do t'u kërkojë anëtarëve të Këshillit të Sigurimit dhe bashkësisë ndërkombëtare ta mbajnë paqen dhe sigurinë ndërkombëtare duke njohur Juan Guaido si presidentin kushtetues të përkohshëm të Venezuelës dhe do të kërkojë mbështetje për qeverinë kalimtare në përpjekjen e tyre për ta rivendosur demokracinë dhe sundimin e ligjit", thuhet në deklaratë.
Takimi i Këshillit të Sigurimit u kërkua nga Shtetet e Bashkuara, pasi ShBA-ja dhe një numër vendesh në rajon thanë se e njohin Guaidon si kreun e përkohshëm të Venezuelës, si dhe i kërkuan presidentit të kontestuar, Nicolas Maduro, të largohej. Maduro është kritikuar për shkeljen e të drejtave të njeriut dhe për trajtimin e ekonomisë së Venezuelës.
Kërkesa ndaj Këshillit të Sigurimit përballet me kundërshtimin nga Rusia e cila ka shprehur mbështetje për aleatin e saj Maduro.









# BeyAb for bread

Risi, tani BEYAB-in mund ta gjeni edhe nëpër dyqanet e Kosovës. BeyAb është prodhim turk, dhe përpos tregut në Shqipëri e Mal të Zi tani edhe në Kosovë.






E rrallë

# Ford Fiesta e vitit 1978, e pa përdorur del në ankand

Ford Fiesta ka qenë një nga makinat më të shitura dhe më të njohura në Evropë. Po shpresohet të bëhet sërish makina më e shitur në Britaninë e Madhe në vitin 2019. Makina e prodhuar në vitin 1978, që qëndroi në muzeun e shkencës në Londër nga viti 1980 deri në 2017, do të dalë në ankand. Raportohet se Ford



Fiesta nuk ka ecur asnjëherë në rrugë publike. Mjeti mund të dalë në shitje për 8 500 paund muajin e ardhshëm.

FOTO E DITES



Punëtorët emigrantë indianë shihen duke ecur mbi një furrë me tulla në Nepal. /AP/

E jashtëzakonshme

# Shitet shtëpia më e shtrenjtë në historinë e ShBA-së



Shtëpia më e shtrenjtë në historinë amerikane u shit për 238 milionë dollarë. Blerësi është Ken Griffin, një investitor profesionist, i cili bleu shtëpinë katërkatëshe (nga 50 në 53) në Central Park South në ndërtesën e njohur si "bunkeri i miliarderëve". Ndërtesa është një lloj klub privat në të cilin ka dhoma private të ngrënies, një klub sportiv, një bar lëngje, një bibliotekë dhe një fushë basketbolli. Përveç investitorit, pak është i njohur për blerësit e tjerë: ndër blerësit do të kishte edhe Sting dhe gruaja e tij Trudie Styler.

## BARSOLETA E DITËS



**Kthehet djali prej shkolle dhe e pyet i ati:**
**- A e përmirësove atë njësh në matematikë, bir?**
**- Jo baba, se është e shkruar me laps kimik.**

KINO ABC PRISHTINE

## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

**Në ora 16:00**

### "THE GRINCH" 3D,

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 ore 30 min

Rolet: Benedict Cumberbatch, Rashida Jones, Kenan Thompson, Cameron Seely, Angela Lansbury, etj.

Regjia: Scott Mosier, Yarrow Cheney






**Në ora 17:30**

### "THE NUTCRACKER AND THE FOUR REALMS" 3D

Aventure/Fantazi/Familjar; 1 ore 39 min

Rolet: Keira Knightley, Mackenzie Foy, Eugenio Derbez, Mathew Macfayden, Helen Mirren, Morgan Freeman, etj.

Regjia: Lasse Hallstrom, Joe Johnston

**Në ora 19:30**

### "MORTAL ENGINES" 3D,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Hugo Weaving, Hera Hilmar, Robert Sheehan, Jihae, Ronan Raftery, Leila George, Patrick Malahide, Stephen Lang, etj.

Regjia: Christian Rivers







**Në ora 22:00**

### "HUNTER KILLER",

Aksion/Aventure/Fantazi; 2 ore 08 min

Rolet: Gerard Butler, Gary Oldman, Common, Linda Cardellini, Toby Stephens, Michael Nyqvist, Caroline Goodall, etj.

Regjia: Donovan Marsh

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Përfitoni nga kjo ditë për të folur më hapur me partnerin tuaj dhe për të sqaruar të gjitha keqkuptimet që keni pasur. Për sektorin e financave do të kujdeseni më tepër dhe nuk do të keni asnjë të papritur.



**DEMI**
Marrëdhënia juaj me partnerin do të jetë më e mirë dhe më e bukur gjatë kësaj dite. Do të tregoheni më të kuptueshëm dhe do ta toleroni partnerin. Në planin financiar duhet të përdorni një strategji tjetër nëse doni t'ia dilni.



**BINJAKËT**
Ditë e mirë kjo e sotmja për të dashuruarit. Priten përmirësime në jetën në çift, pas një periudhe jo fort të këndshme. Sektori i financave do të jetë i brishtë.



**GAFORRJA**
Partneri do të jetë më i disponueshëm gjatë kësaj dite të kalojë kohë me ju dhe t'ju bëjë të ndiheni sa më mirë. Klima në planin financiar do të jetë e favorshme për investime.



**LUANI**
Çiftet që kanë pasur probleme kohët e fundit do ta kenë të vështirë të krijojnë një ambient të ngrohtë, megjithatë nuk duhet të mërziten. Situata financiare do të jetë e qëndrueshme.



**VIRGJËRESHA**
Do të bashkëpunoni mjaft me partnerin tuaj sot dhe do t'i shprehni gjithçka atij pa druajtje. Në fakt, edhe pse atij nuk mund t'i pëlqejë diçka, është gjëja më e mirë që mund të bëni. Në plani financiar situata do të jetë paksa delikate.



**PESHORJA**
Në çift marrëdhënia me partnerin do të jetë e mirë. Të dy do të ndani të njëjtat mendime mbi tema të caktuara dhe do planifikoni të ardhmen. Në planin material do të fryjë një flad i ngrohtë.



**AKREPI**
Nën ndikimin e Venusit do të kërkoni më shumë qetësi në jetën tuaj në çift. Në planin financiar do të bënit mirë të mos e humbnisit vigjilencën dhe maturinë.



**SHIGJETARI**
Jeta në çift do të vazhdojë të jetë e mirë edhe gjatë kësaj dite. Do të flisni hapur me partnerin dhe nuk do t'i mbani asnjë të fshehtë njëri-tjetrit. Tregohuni sa më të arsyeshëm në planin financiar gjatë kësaj dite që mos keni tronditje.



**BRICJAPI**
Dita e sotme do të jetë e dyzuar në planin sentimental. Nga njëra anë do t'ia shprehni ndjenjat partnerit, nga ana tjetër do të tregoheni shumë xheloz. Financat do të jenë prioritet për ju.



**UJORI**
Do të jeni sharmant, joshës dhe me humor shumë të mirë sot. Së bashku me partnerin do të provoni përvoja të reja dhe do të ndërmerrni sfida. Gjithçka do të shkojë për mrekulli. Në planin financiar, fati do të jetë në anën tuaj.



**PESHQIT**
Nuk do t'ju pëlqejnë aspak rregullat strikte në çift dhe do të debatoni me partnerin sot. Ulni sa t'i mundni shpenzimet në planin financiar dhe menaxhoni me maturi të ardhurat që keni.

# Joe Jonas bën tatuazh këngën e grupit "Electric Light Orchestra"






Këngëtari dhe aktori Joe Jonas ka publikuar një fotografi në rrjetet sociale ku njofton fansat se ai ka bërë një tatuazh të ri në krahë. Ky tatuazh ka kuptimin e një pjese të këngës Mr. Blue Sky nga Electric Light Orchestra e cila u realizua në vitin 1978.

# Reperi shqiptar kërkon nuse për shtëpi



Ai është një nga reperët më të pëlqyer nga publiku, këngët e të cilit janë kthyer në hite, po edhe ndër djemtë më tërheqës të shoubizit. Bëhet fjalë për Seven Saraçin, reperin i cili u komentua shumë së fundmi për këngën "Maria", në bashkëpunim me Tunën dhe Vildane Zenelin. Seven duket se është lodhur nga vajzat e "Instagram"-it dhe ka thënë se po kërkon një vajzë për shtëpi. "Modelet e 'Instagram'-it janë të mbivlerësuara. Dua një vajzë për shtëpi, me të pasme, që di të gatuaj mirë pite", ka shkruar ai.



© Kylie Jenner/Instagram

# Kylie do ta promovojë koleksionin e linjës kozmetike për Shën Valentin

Biznesmenja e njohur Kylie Jenner me anë të disa publikimeve në rrjetet sociale i ka njoftuar konsumatorët e vet se më 1 shkurt do ta promovojë koleksionin e linjës kozmetike për Shën Valentin. Edhe këtë herë si duket Kylie do të jetë pjesë e kampanjës ku shihet se është e veshur shumë bukur dhe e grymosur.



# Kelly nis turneun "Meaning of Life"

Kelly Clarkson ka performuar në koncertin e saj të parë të turneut "Meaning of Life" dhe lista e ekipit të saj tashmë është zbuluar. Këngëtarja 36-vjeçare, fituese e American Idol dhe momentalisht trajnere e "The Voice", do të jetë në turne muzikore rreth Amerikës për dy muajt e ardhshëm së bashku me Kalsea Ballerini dhe Brynn Cartelli.



Autor: GAZMEND MORINA

KËNGËTARJA AMERIKANE NË FOTO (shqip.)
SHUMË, TEJ MASE
PIKA MË E LARTË NË KUPËN E QIELLIT (pashq.)
UNIVERSITY LANCASTER OHIO
TINARI
SHTËPIZA E NDËRTUAR ME DËRRASA
ZANORE
GUR I ÇMUAR ME NGJYRË TË KALTËR OSE TË GJELBËR
PIANISTJA LULE .....
KËNGËTARJA .... MUÇAJ

LËNG I TRASHË VESHTULLOR QË NXIRRET NGA KULLIMI I NAFTËS
PELLG I HAPËT PËR TË GRUMBULLUAR UJË / BASHKËT.
KËNGËTARJA ....... EMINI
PËRGJIGJE NË TELEFON / E GDHENDA
SHKËMB I PËRBËRË PREJ RËRE
ARBITËR / BEREQET
LETRARI ASLLANI
METODË STUDIMI / PËRSHTATJE (sh.shq.)
VETIA THELBËSORE E QENIEVE TË GJALLA
FLUTURUESI I PARË SIPAS MITOLOGJISË / SHTET FEDERAL NË SHBA
QË ËSHTË LËNË I LIRË, PA FRE
KALË SHALE
THIKË QË MBAHEJ SI ARMË BREZI (sh.shq.) / "KENIA"
GJË E RRALLË E ME VLERË (Lat.)
ZANORE / GAZ QË SHPËRTHEN KUR DIKUSH TALLET ME DIKË
BASHKËT.
PJESË E FORTË E BUKËS / "RISANI"
LLOJ BIME ME TË CILAT BËJMË PILAF

LOJ PËLHURE E TRASHË SI STOF
QË I MOHON NORMAT E MORALIT
AKTORJA E FAMSHME ANDERSON
VESHJE E SIPËRME PREJ SHAJAKU / LLOJ LOJE FATI
MURG I VETMUAR / AMPER, RENIUM
DALLGA / SHOK

DAMARI I GJAKUT
OLIVIA ZUMWALT / INSTITUTE DEFENSE ANALYSES
TENISTI ..... SAFIN / BASHKËT.
DILETANTI
IDHULLI / KËNGËTARJA LIBOHOVA
"IRLANDA" / KËNGËTARJA GANIMETE
GABZHERRI, GURMAZI
BIMË BARISHTORE NJËVJEÇARE QË PËRDORET SI USHQIM
FUTBOLLISTI .... XHEKO / FUTBOLLISTI SENEGALEZ ARMAND ..... (QPR)
GJAKATAR / KUVENDI I KOSOVËS
AKTORJA ..... PAPAS
KËRCELL I BIMËS SË MISRIT / ZANORE
SHKRONJË GREKE / NDODHEM RASTËSISHT NË NJË VEND
DHUROJ DIÇKA
RANISHTJA / PËSHTJELLIM (shq.)
ZANORE / I AFRUAR
GRYKË E VULLKANIT / LECKA PËR ARNIM
HOVI, VRULLI
KËNGËTARJA AMERIKANE ..... BAKER / BASHKËT.
ANGOLA, ZAMBIA / ZANORE
TITAN / VAJZA E DJALIT A E VAJZËS

SHKRIMTARI ....... HAZIRI
I PARI I MURGJVE NË NJË ABACI (pashq.)
BASHKËT. / KAFSHË SHTËPIAKE ME TRUP E ME QAFË TË TRASHË
KLUB FUTBOLLI NË HOLANDË / RADIUM, ZET
HUMORISTI ..... THAQI / PJESË E ILIRISË
BASHKËT. / SIGURIM I GJËRAVE TË NEVOJSHME PËR JETESË (bised.)
RADIOLOKATOR
BIMË E CILA PËRDORET PËR USHQIM / RAPSODI BERISHA (shq.)
BASHKËT. / ROMANCIERI GJERMAN ERIK MARIA
KËNGËTARJA JONË '... MAMA'
LIBËR FILLESTAR
KAMPIONI / MËSYMJE
ISH FUBOLLISTI BRAZILIAN ... GASPAR (ARSENAL) / VEZAK
ÇMENDURI; BUDALLALLËK
BABAI / AMERICAN TEATRE ORGAN SOCIETY
E BITISA / I NDESH
VEZË PESHKU (shq.)
ARTIOLA TOSKA
BASHKËT. / BUILDING INFORMATION MODELING
REGJISTRIM NË FATURË I ÇMIMIT TË NJË MALLI / SIENA
KAPI DIÇKA TE PJESA E SIPËRME NË NJË GOZHDË / TEXAS EDUCATION AGENCY
BASHKËT.
BESËLIDHËS / RAMADAN AVDIU
KOB / BEN AFLEK
ERNEST KOLIQI / AFËRDITA DRESHAJ
KLUB FUTBOLLI NË GREQI
BASHKË, ME / TOTENHAM
SHTRATI QË PËRDORET PËR TË MBARTUR TË SËMURËT / BASHKËT.
BASHKËT. / ZANORE
PËSHPËRIT DIKUJT FJALË MAGJIKE
MBULESA QË E VË DIKUSH NË FYTYRË PËR TË MOS U NJOHUR NGA TË TJERËT
DËSHIROJ

# Hapen zyrtarisht zyrat e MKRS-së në qytetin e Prizrenit




Nga dita e premte një pjesë e stafit politik, administrativ dhe profesional e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) është zhvendosur në qytetin e Prizrenit

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRIZREN, 25 JANAR - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit tanimë do të jetë e pranishme zyrtarisht në qytetin jugor të Kosovës, në Prizren. Në një ceremoni të organizuar nga MKRS-ja, të premten është bërë hapja e zyrave të ministrisë në qendrën historike të qytetit, në ish-objektin e Rektoratit të Universitetit të Prizrenit.
Në ceremoni morën pjesë personalitete të shumta nga jeta politike dhe kulturore e vendit. Ndër të pranishmit në këtë ngjarje, ku u përurua hapja e zyrave të MKRS-së në Prizren, ishin kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, ministri i MKRS-së, Kujtim Gashi, e deputetë të Kuvendit të Kosovës. Me këtë rast, ministri Kujtim Gashi ka folur për rolin që do të ketë Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Prizren, duke e pasur parasysh edhe rëndësinë historike, kulturore dhe të trashëgimisë që ka qyteti dhe rrethina e tij.
Me këtë rast, ministri Gashi ka thënë se sot kemi hapur edhe zyrtarisht zyrat e MKRS-së në qytetin historik të Kosovës në Prizren. "Me qëllim të avancimit dhe përkrahjes më të madhe institucionale ndaj vlerave historike, kjo zhvendosje u bë për të qenë sa më afër qytetit më kulturor të Kosovës dhe nga sot zyrtarisht një pjese e stafit politik, administrativ dhe profesional u zhvendos në Prizren. Sërish Prizreni, kryeqyteti historik i shqiptarëve, na ka bashkuar, kësaj here për t'i inauguruar zyrat e MKRS-së në të cilat do të punojnë një pjesë e kabinetit tim ministror, si pjesë e fazës së parë për ta sjellë Ministrinë e Kulturës në Prizren dhe për ta jetësuar premtimin elektoral të kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës, z. Veseli", u shpreh tutje ministri.
Ministri Gashi hapjen e zyrave të MKRS-së e konsideroi një ditë feste për qytetarët e Prizrenit. "Sot kryeqyteti i kulturës merr epitetin e një qyteti administrativ sepse atë që Qeveria e Lidhjes Shqiptare te Prizrenit nuk arriti ta bënte, Qeveria e Republikës së Kosovës, shteti ynë, po e bën historí", ka thënë Gashi. "Nga sot MKRS-ja do të jetë afër festivaleve kulturore e afër traditës sportive, për t'i mbështetur ato, për ta ruajtur e mbrojtur trashëgiminë e pasur kulturore. Nga sot MKRS-ja është në qytetin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, në qytetin e Bekim Fehmiut, në qytetin e 'Dokufest'-it, Zambakut të Prizrenit, qytetin e diversitetit kulturor, komunikimit kulturor ndërkombëtar, në qytetin e shoqërisë 'Agimi' e Ansamblit 'Emin Duraku', në kryeqytetin shpirtëror të shqiptarëve, të patriotëve e heronjve si Ymer Prizreni, Remzi Ademaj, Xhevat Berisha, Agim Shala e shumë dëshmorëve të UÇK-së", ka thënë ministri Gashi në fjalën e tij duke falënderuar kryetarin e Kuvendit, Kadri Veseli, për mbështetjen dhe premtimin e mbajtur që në perlën e trashëgimisë së kulturës, në Prizren, ta sjellin Ministrinë e Kulturës.
Ndërkaq kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, ka thënë se prej sot Prizreni do ta ketë qendrën e vet përderisa ky s'do të jetë i vetmi institucion që do ta ketë Prizreni. "Sa herë që pyetem nga ndërkombëtarët se cili është vendi që duhet vizituar në Kosovë, unë i them Prizreni. Ky qytet është nyje e kombit tonë, nyje e transformimit të një identiteti të ri. Prizreni është interes i një Kosove dhe jo i një partie", ka thënë Veseli.

# Aprovohet raporti i punës dhe plani i veprimit i koordinatorit Hoti



PRISHTINË, 25 JANAR (ER) - Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e së premtes ka aprovuar raportin e punës të vitit 2018 dhe planin e veprimit të Koordinatorit Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2019. Raporti i punës dhe plani i veprimit u prezantua para kabinetit qeveritar nga Koordinatori Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport, Rexhep Hoti.
Koordinatori Hoti ka folur për Programin Nacional për Rininë duke treguar për ecurinë e implementimit si dhe për rëndësinë e tij në stimulimin e nxënësve. "Për herë të parë Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar një program që përfshinë të gjithë nxënësit pa përjashtim dhe pa dallim. Në kuadër të programit do të mbahen gara në fushën e diturisë, sportit dhe kreativitetit kulturor e mendimit kritik. Do të ndahen mbi 30 000 shpërblime për të gjithë fituesit e vendit të parë. Ky program do t'i angazhojë dhe ndihmojë edhe prindërit, mësimdhënësit, drejtorët dhe të gjithë shoqërinë", ka thënë koordinatori Hoti.
Ndërsa kryeministri Ramush Haradinaj ka theksuar edhe një herë mbështetjen që ai i ofron koordinatorit Hoti për implementimin e këtij programi. "Sot miratuam planin e veprimit të Programit Nacional për Rininë të Koordinatorit Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport. Është një program për mbi 340 mijë nxënës dhe mbi 110 mijë studentë andaj unë shfrytëzova rastin që edhe në mbledhjen e qeverisë të falënderoj z. Rexhep Hoti për këtë", u shpreh kryeministri Haradinaj. Hoti ka njoftuar se gara në shkolla do të fillojë në këtë gjysmëvjetor. Po ashtu, Hoti ka pohuar se është përfunduar edhe drafti i Programit Ndërshtetëror për Rininë për Shqipërinë dhe Maqedoninë i cili së shpejti do t'u prezantohet këtyre shteteve.




Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

| | |
|---|---|
| ACCRINGTON STANLEY - DERBY | 3+ |
| ATLETICO MADRID - GETAFE | X-1 |
| WERDER - EINT. FRANKFURT | 3+ |

# Papuqi: Moszhvillimi i asnjë ndeshje zyrtare për Kosovën, pengu më i madh në karrierë

Mbrojtësi legjendar i Besës së Pejës, Finsik Papuqi, ka fituar shumë tituj në futbollin e Kosovës, por pengun më të madh e ka që nuk ka mundur të bëjë asnjë ndeshje zyrtare me Përfaqësuesen e Kosovës. "Kur është bërë pranimi i Kosovës në UEFA dhe FIFA unë kisha një moshë të lartë dhe e dija se më nuk mund të kontribuoj në përfaqësuese dhe është mëkat që mbas gjithë atyre viteve të suksesshme nuk mund të paraqitem në një ndeshje zyrtare për Kosovën, por kështu e ka futbolli", ka thënë Papuqi

EPOKA E RE Veton ZYMBERI



**Prishtinë, 25 janar** - Futbollisti Fisnik Papuqi është një nga lojtarët më të mirë në futbollin e pasluftës, kurse edhe sukseset që ka arritur ky futbollist janë të shumta. "Fisi" filloi të merret me futboll qysh në moshën tetëvjeçare, kurse debutim e ka bërë në moshën 17-vjeçare në ndeshjen Trepça '89 - Besa, nën drejtimin e trajnerit tashme të ndjerë Tahir Vokshi. Papuqi të premten për "Epokën e re" ka thënë se momentet më të mira i kaluar në Besën e Pejës, por edhe në skuadrën e Vëllaznimit dhe Hysit kishte kaluar momente që nuk do t'i harrojë gjatë gjithë jetës së tij. "Normalisht se momentet më të mira i kam kaluar në skuadrën e Besës në vitet e arta të kësaj skuadre 2002-2007. Momente të mira dhe të paharrueshme kam pasur edhe në Klubin e Vëllaznimit dhe te Hysi. Me skuadrën e Vëllanzimit e kemi fituar Kupën, por më ka mbetur merak që e humbëm titullin dhe qyteti i Gjakovës meriton shumë më futboll, pasi jeton me Vëllaznimin. Ndërsa në skuadrën e Hysit kemi kujtime të mira, pasi e kemi fituar titullin e kampionit dhe shoqëria ka qenë shumë e mirë", ka thënë Papuqi.

Mbrojtësi Fisnik Papuqi nuk është anëtari i vetëm i familjes që ka luajtur futboll, pasi me sukses të njëjtën gjë e ka bërë edhe vëllai i tij më i vogël, Florenti. "Fisi" ka treguar për gazetë se është një kënaqësi e madhe kur luan në një klub së bashku me vëlla, pasi edhe rezultati nuk mungon. "Është një ndjenjë e mirë që të luash me vëllanë në një klub, por edhe në një repart. Me Florentin ka qenë lehtë të luash sepse ka qenë lojtar shumë inteligjent edhe për atë arsye ta ka lehtësuar mjaft shumë punën. Normalisht se kur kuptohesh del edhe i suksesshëm", ka treguar Papuqi.

Në ndeshjen miqësore në mes të përfaqësueses së Kosovës dhe Kombëtares së Shqipërisë, Fisnik Papuqi ka qenë një nga lojtarët që ka treguar formën më të mirë dhe pas ndeshjes trajneri i atëhershëm i kombëtares kuqezi, Gianni De Biasi, e kishte lavdëruar mbrojtësin pejan. "Ndeshja Kosovë - Shqipëri ishte një ndër ndeshjet më emocionale në përfaqësuese që e kam luajtur dhe kam kujtime të paharruara në përfaqësuese. Kur është bërë pranimi i Kosovës në UEFA dhe FIFA, unë kisha një moshë të lartë dhe e dija se më nuk mund të kontribuojë në përfaqësuese dhe është mëkat që mbas gjithë atyre viteve të suksesshme nuk mund të paraqitem në një ndeshje zyrtare për Kosovën, por kështu e ka futbolli", ka thënë Papuqi.

Skuadra e Besës së Pejës, ku Papuqi është zhvilluar si futbollist dhe arriti t'i fitojë të gjitha trofetë e mundshëm në futbollin e Kosovës, është duke kaluar një krizë të thellë. Kjo skuadër tash po bënë gara në Ligën e Parë dhe do ta ketë vështirë rikthimin në elitë për edicionin e ardhshëm, por Papuqi shpreson se ditët e mira për ish-klubin të vijnë sa më shpejt të jetë e mundur. "Do Zoti që Besa ta kalojë krizën sa ma shpejt dhe të rikthehet aty ku e ka vendin, sepse ky klub dhe qyteti i Pejës nuk e meritojnë këtë gjendje", ka shtuar ai.

